

AKTI THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR (SHPK) " WALKINGPAD ALBANIA"

Sot më datë 29.11.2024 Anëtarë Themelues:

1. Jashar Stojku, atësia Luan, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.12.2003 lindur në Tiranë dhe banues në Fushë-Krujë, identifikuar me nr. Personal K31229056T , madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Po veproj në cilësinë e themeluesit të vetëm të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), pas shqyrtimit të rregulloreve dhe ligjeve përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe të tjera dispozita në fuqi, vendosa të krijoj një shoqëri të tillë, për të cilën përpiloj dhe nënshkruaj aktin e mëposhtëm të themelimit.

KREU I

EMRI I SHOQËRISË , SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

EMRI I SHOQËRISË

- 1.1 Emri i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "WALKINGPAD ALBANIA" (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

NENI 2

SELIA

2.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Krujë, Fushë-Krujë, Rruga Luz, Zona Kadastrale 2537, me Nr. Pasurie 5/29 Vol.8, Faqe 179.

2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3


KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të përcaktuar.

NENI 4

OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të

Jashar Stojku 

Republikës së Shqipërisë , duke u fokusuar në: Tregti pajisje elektronike, pajisje palestere, importin e pajisjeve elektronike , produkte kozmetike etj.

- 4.2 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur ndihmes me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

KREU II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

5.1 Kapitali fillestar i shoqërisë është 1000 (njëmijë) Lekë. Kapitali i shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortaku që zotëron 100% (njëqind për qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë; përkatësisht:

- Z. Jashar Stojku, atësia Luan, shtetas shqiptar, i datëlindjes 29.12.2003 lindur në Tiranë dhe banues në Fushë-Krujë, identifikuar me nr. Personal K31229056T , madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar; i cili zotëron 100% të kapitalit.

5.2 Kapitali i shoqërisë mund të rritet vetëm me miratimin e personit të vetëm themelues.

KREU III

MENAXHIMI I SHOQËRISË

1. Shoqëria do të administrohet dhe menaxhohet nga Jashar Stojku, i cili është i autorizuar të marrë çdo vendim në emër të shoqërisë.
2. Menaxheri është i vetmi përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të shoqërisë dhe për zbatimin e politikave dhe procedurave të miratuara.

KREU IV


TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AKSIONARËVE

1. Si aksionar i vetëm, Jashar Stojku ka të drejtë të marrë vendime për çështje të rëndësishme, përfshirë shpërndarjen e fitimeve, ndryshimet në statut dhe çdo vendim tjetër që ndikon në zhvillimin e shoqërisë.
2. Aksionari i vetëm është i detyruar të kontribuojë në kapitalin fillestar dhe të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret që lidhen me operimin e shoqërisë.

KREU V

PËRDORIMI I FITIMEVE

1. Fitimi i shoqërisë do të shpërndahet vetëm për qëllime të zhvillimit të shoqërisë ose do të përdoret për investime të reja, me miratimin e pronarit të vetëm të shoqërisë.

Jashar Stojku 

KREU VI

SHKARKIMI I SHOQËRISË

1. Shoqëria mund të shkarkohet në çdo moment me vendim të pronarit të vetëm të shoqërisë, i cili mund të vendosë për shpërbërjen e shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
2. Në rast shkarkimi të shoqërisë, pronari i vetëm do të merret me shpërndarjen e pasurisë së mbetur pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë.

KREU VII

RREGULLAT PËR NDRYSHIMIN E STATUTIT

1. Ky statut mund të ndryshohet ose plotësohet nga pronari i vetëm i shoqërisë, në çdo kohë, për sa kohë që ndryshimet janë të përputhshme me ligjin dhe interesin e shoqërisë.

ORTAK THEMELUES TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

JASHAR STOJKU

Jashar Stojku 